



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe
Financat

Tiranë, më 18.6.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PPP,
NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
DHE “GJIKURIA”, SH.P.K., SI KONCESIONARI, DHE SHOQËRISË
KONCESIONARE “RRUGA ORIKUM - LLOGARA”, SH.P.K., PËR NDËRTIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E RRUGËS “PORTI I JAHTVE - BY-PASS ORIKUM - DUKAT
(URA E SHËN ELIZËS)”**

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 qershor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe “Gjiguria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe Shoqërisë Koncesionare “Rruga Orikum-Llogara”, sh.p.k., për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahtve - By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Blerina Gjylameti.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e

Shqipërisë”. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.**

Projektligji është pjesë e programit të Qeverisë, të prezantuar si “Programi një milionë euro”, i cili synon ndërhyrjen e menjëherhme në infrastrukturë, duke përdorur investimet nga kapitali privat në fazën e ndërtimit dhe kthimi i investimit do të bëhet në vitet e ardhshme, duke u paguar nga buxheti i shtetit.

Projekti që parashikohet në këtë kontratë synon ndërtimin e një rruge prej 14.7 km, që fillon në Rrugën Porti i Jahteve, e cila më pas kalon në *By-Pass* Orikum dhe përfundon në Dukat (Ura e shën Elizës).

Projekti është paraqitur nga koncesionari në formën e propozimit të pakërkuar dhe është mbështetur nga komisioni i dhënies me koncesion/PPP në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr. 634, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar. Komisioni bëri analizën e rentabilitetit, fizibilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare të projektit, duke vendosur dhënien e bonusit shoqërisë që ka paraqitur propozimin. Më pas, strukturat përgjegjëse e kanë vlerësuar projektin si të mundshëm dhe me interes publik.

Projekti përmbush parimin e shpërndarjes efektive të riskut, pasi koncesionari ka marrë përsipër pjesën më të madhe të risqeve, për të ofruar një projekt me cilësi dhe standard të lartë. Mospërmbushja e kriterit të cilësisë së projektit do të sillte kosto shtesë për koncesionarin.

Periudha e koncesionit është 13 vjet, nga të cilat 3 vjet është faza e ndërtimit dhe 10 vjet faza e mirëmbajtjes. Projekti ka disa prioritete, si:

- përfshirja e disa pikave të reja strategjike, sikurse është Porti i Jahteve;
- kalimi në trasenë e re të *By-pass*-it të Orikumit dhe lidhjen me përfundimin e *Bypass*-it të Vlorës;
- le të mundshme të dyja zgjidhjet e mëvonshme për kalimin e Llogarasë, me tunel ose në trasenë ekzistuese.

Vlera e plotë e projektit është rreth 67.4 milionë euro dhe do të mbulohet nga burimet si më poshtë:

- 21.8 milionë euro nga kapitali i shoqërisë;
- 25.6 milionë euro hua bankare;
- Diferenca (20 milionë euro) nga buxheti i shtetit.

Norma e interesit të huasë bankare dhe e kapitalit të shoqërisë është 5 për qind.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja paraqiti projektligjin, duke u ndalur në thelbin e kontratës së koncesionit, si dhe impaktin që ajo pritet të ketë në zhvillimin ekonomik të zonës dhe të ekonomisë në tërësi.

Propozuesit e projektligjit paraqitën një informacion të detajuar për kontratën e koncesionit, në përgjigje të pyetjeve të deputetëve. Ata theksuan se çmimet e referuara në kontratë janë në përputhje me çmimet e manualeve që përdor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Deputetët e mazhorancës e konsideruan kontratën e Koncesionit/PPP për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës) me rëndësi të veçantë, pasi ajo do të sjellë rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në zonën e Vlorës, zhvillimin e turizmit, lehtësimin e trafikut dhe reduktimin e incidenteve. Zbatimi i këtij projekti do të mbështesë zhvillimin e sektorëve strategjikë, duke gjeneruar rritje të të ardhurave, punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve. Ky aks rrugor është një nga segmentet më të rëndësishëm të konektivitetit si brenda vendit, ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor. Kostoja e projektit është përlllogaritur me çmimet sipas manualeve për zona gjeologjike të ngjashme.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan kontratën e koncesionit/PPP për këtë segment rrugor, duke pretenduar se kostoja e projektit është e lartë dhe rëndon buxhetin e shtetit.

Komisioni kërkon që strukturat përgjegjëse ekzekutive të monitorojnë me rigorozitet zbatimin e kontratës së koncesionit/PPP, për të mundësuar ndërtimin e një segmenti rrugor me parametra cilësorë të lartë dhe për të siguruar mirëmbajtjen e vazhdueshme të tij, në përputhje me kontratën. Ministria e Financave dhe Ekonomia duhet të ndjekë vazhdimisht koston e projektit, për të siguruar zbatimin e treguesve të parashikuar në kontratë dhe në ligjin e buxhetit, duke ndikuar në vijimin e qëndrueshmërisë së financave publike. Gjithashtu, Komisioni kërkon rritjen e transparencës ndaj publikut në drejtim të informimit për koston e projektit, si dhe detaje të tjera të tij.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicë votash.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Arben AHMETAJ